

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, BLLATË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Bllatë me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën 2012-2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 104, datë 07.08.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 434/7, date 07.08.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Abdulla Kata, Kryetar i Degës Doganës, Bllatë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Bllatë, të merren masa për rikuperimin e borxhit doganor në vlerën prej 98,520 mijë lekë, gjendje më 31.12.2013, duke përdorur të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore si dhe duke rritur efektivitetin në zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, QKR dhe bankat e nivelit të dytë për vjeljen me forcë të borxhit doganor si dhe me Zyrat Përmbarimore, për zbatimin e Urdhrave të Ekzekutimit të lëshuara nga Gjykata.

2. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Bllatë, të dërgojë për investigim në Departamentin Operativ Hetimor, pranë DPD, praktikën doganore Imp. 4, R-911, datë 29.08.2013, trajtuar në faqen 60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Bllatë, të merren masa për të mos pranuar në procesin e zhdoganimit :

-kontratat që operatorët ekonomikë vendas lidhin me eksportuesit e mallrave, jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, për t’u pranuar si të tilla, trajtuar në faqet 14-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-dokumentet fotokopje që shoqërojnë deklaratat doganore në procesin e zhdoganimit të mallrave për vlerësim si kontrata, fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e parkingut, libreza e mjetit, jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007, të Ministrit të Financave, trajtuar në faqet 14-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- si “Certifikate of origin & Quality”, dokument të nënshkruar nga kompania eksportuese por vetëm certifikatat e origjinës që lëshohen nga Dhomat e Tregtisë si dhe në vend të vërtetimit të origjinës faturën e lëshuar nga “eksportuesi i miratuar” në kundërshtim kjo me Udhëzimin e DPD-së nr. 5883 datë 16.05.2006 “Dokumentacioni i detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”.

4. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Bllatë, të marrë masa për plotësimin e praktikave doganore me librezat e mjetit transportues dhe certifikatat e peshimit bosh, në zbatim të udhëzimeve të DPD nr. 1 datë 01.11.2002; nr. 600 datë 03.12.2009; nr. 27 datë 01.01.2012 dhe nr. 1467, datë 26.11.2012.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Dega e Doganës Bllatë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën prej **10,020,529 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **1,714,325** lekë, nga subjekti [REDAKTUAR] sipas trajtimit në faqet 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit; vlera prej **2,374,763** lekë nga subjekti [REDAKTUAR] sipas trajtimit në faqet 27-49; vlera prej **3,566,917** lekë nga subjekti [REDAKTUAR] sipas trajtimit në faqet 53-54; vlera prej **175,326** lekë, nga subjekti [REDAKTUAR], sipas trajtimit në faqet 56-57; vlera prej **105,668** lekë, nga subjekti [REDAKTUAR], sipas trajtimit në faqet 49-50; për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore, duke pranuar vlerën e transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret e KD.
2. Vlera prej **1,044,352** lekë nga subjektet: [REDAKTUAR] në vlerën prej 389,574 lekë dhe [REDAKTUAR] në vlerën prej 654,778 lekë, sipas trajtimit në faqet 70-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për shkelje të procedurave të vlerësimit të taksës së rentës minerare, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” neni 40; Ligjin nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 117.
3. Vlera prej **398,929** lekë nga gjashtë persona, në shtatë raste: 1. [REDAKTUAR] vlera prej 24,868 lekë, 2. [REDAKTUAR] vlera prej 8,000 lekë, 3. [REDAKTUAR] vlera prej 55,853 lekë, 4. [REDAKTUAR] vlera prej 85,243 lekë në dy raste, 5. [REDAKTUAR] vlera prej 212,622 lekë, 6. [REDAKTUAR] vlera prej 12,343 lekë, për llogaritje të gabuar në zhdoganimin e autoveturave, në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet, nenet 34-40, trajtuar në faqet 50-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
4. Vlera prej **385,492** lekë nga subjektet: [REDAKTUAR] vlera prej 189,174 lekë; [REDAKTUAR] vlera prej 196,318 lekë, trajtuar në faqet 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe vlera prej **232,849** lekë nga subjektet: [REDAKTUAR] vlera prej 103,953, lekë, [REDAKTUAR] vlera prej 78,520 lekë; [REDAKTUAR] vlera prej 10,634 lekë dhe [REDAKTUAR] vlera prej 39,742 lekë, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore për artikullin “pëlhurë sintetike” dhe “mallra të përdorura” në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet, nenet 34-40.
5. Vlera prej **22,008** lekë nga z. [REDAKTUAR] për diferenca në magazine, trajtuar në faqen nr. 68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, pika 1, 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Kreu II, pika 3, 6, 9, 10 dhe 11, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës, Bllatë që, në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 për nëpunësit civil të Degës Doganës, Bllatë, si më poshtë:

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik, për mospërputhjet e konstatuara në sektorin e klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit në 5 deklaratat doganore për subjektin [REDAKTUAR]; 1 deklaratë doganore për subjektin [REDAKTUAR]; dhe për subjektin [REDAKTUAR]; në 9

deklarata doganore për subjektin [REDAKTUAR]; 1 deklaratë doganore për subjektin [REDAKTUAR] dhe të shoqëruara me mungesë të ardhurash në detyrime doganore dhe mosaplikim të penalteteve sipas KD, trajtuar në faqet 14-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Për z. [REDAKTUAR], me detyrë Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik, për mospërputhjet e konstatuara në sektorin e klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit në 14 deklarata doganore për subjektin [REDAKTUAR], 1 deklaratë doganore për subjektin [REDAKTUAR]; 3 deklarata doganore për subjektin [REDAKTUAR], trajtuar në faqet 14-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik, për mospërputhjet e konstatuara në sektorin e klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit në deklaratat doganore R.1114, datë 2.10.2013, R.1281-1282, datë 04.11.2013, R.1379, 1380, date 25.11.2013, R.1453-1454, date 10.12.2013, R.1477-1488, datë 16.12.2013, R.1496-1497, datë 19.12.2013, të subjektit [REDAKTUAR], R.1350, datë 19.11.2013 për subjekti [REDAKTUAR] të shoqëruara me mungesë të ardhurash në detyrime doganore dhe mosaplikim të penalteteve sipas KD, trajtuar në faqet 14-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik, për mospërputhjet e konstatuara në sektorin e klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit në 6 deklarata doganore për subjektin [REDAKTUAR]; 1 deklaratë doganore për subjektin [REDAKTUAR], të shoqëruara me mungesë të ardhurash në detyrime doganore dhe mosaplikim të penalteteve sipas KD, trajtuar në faqet 14-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë, Përgjegjës i Zyrës Operacionale për periudhën 13.02.2012 deri në datë 31.07.2013 dhe si doganier vlerësim për praktikën R.556, datë 24.08.2011, R.1796 datë 16.11.2012, trajtuar në faqet 14-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë, Përgjegjës i Zyrës Operacionale për periudhën 01.08.2013 deri më 31.12.2013 për R.585, datë 26.06.2013 dhe R.1121, datë 03.10.2013, trajtuar në faqet 14-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Për të meta dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë për 4 ish-punonjësit e cituar në RPA, pasi nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bashkim Shehu, p/grupi, Anesti Gjika, Hodo Hasani, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Bllatë me shkresën nr. 881/1, datë 29.08.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se janë vlerësuar dhe janë marrë masat përkatëse për zbatimin e të gjitha masave organizative të propozuara, të masave për shpërblim dëmi në shumën 670,983 lekë dhe të masave disiplinore për 4 nëpunës.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT